



SBASHK

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures

Arsimimi

KULTURA E NJERIUT

Ë-buletin



Dhjetor, 2020


U mbajtën takimet përmbyllëse të Kryesisë dhe Këshillit Drejtues
**Vlerësim i angazhimeve e arritjeve, marrëveshje çka
tutje**



Në përmbyllje të vitit 2020 SBASHK ka organizuar takime të ndara me Kryesinë dhe me Këshillin Drejtues, si organ më i lartë i SBASHK-ut mes dy Kongreseve. Në këto takime të ndara të organeleve udhëheqëse të SBASHK-ut kryetari Rrahman jasharaj ka paraqitur një raport të shkurtër duke u ndalur në disa nga aktivitetet e zhvilluara me sukses gjatë vitit 2020 duke kujtuar takimet e shumta me përfaqësues të institucioneve qendrore në të cilat është debatuar për kërkesat e anëtarësisë së ...(faqe 4)

Takim me kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe Universiteteve

**Arritje të shumta edhe përkundër kushteve të
vështirësuar**



Me qëllim të këmbimit të informacioneve ...(faqe 8)

Vazhdojnë trajnimet edhe gjatë gjithë muajit dhjetor

**Pjesëmarrësit e vlerësojnë
lart këtë aktivitet të
SBASHK-ut**

Teksa po bëhej raporti
përfundimtar dhe po bëhej
një vlerësim i tërësishëm i
realizimit të...(faqe 9)

Intervistë me koordinatorin
për organizim të brendshëm
Ymer Ymeri

**Arritje të mëdha në një vit
plot sfida**



*Ymer Ymeri është menaxher
për financa e administratë,
por vullnetarisht ...(faqe 3)*

ETUCE mbajti më 1 e 2 dhjetor Konferencën
zgjedhore

**Në raportin e punës vend meritore për
angazhimet e SBASHK-ut**



Kryesia dhe Byroja ekzekutive e Komitetit të
Sindikatave ...(faqe 6)



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës
The Union of Education, Science and Culture

Editorial

Po shkon edhe ky vit



Shumë nga ne kishim shprehur mendime se viti 2019 ishte me plot sfida dhe uronim që viti 2020 të jetë më i mirë për të gjithë qytetarët e Kosovës, por ky viti që po e lëmë solli plot sfida dhe doli të jetë nga më të vështirët në historikun e gjatë e plot ngjarje të arsimit të Kosovës. Në numrin e gazetës “Arsimimi sot” të muajit dhjetor do të kujtoj se në komunikimin me anëtarësinë, qoftë në takimet e shumta nga larg, qoftë duke u kyçur në trajnime, me krenari kam shprehur respekt meritore për gjithë kolegët tanë që edhe në këto kushte tepër të vështirësuar nga pandemia kanë vazhduar me përkushtimin e angazhimit për rrjedhën e mbarë të arsimit në vendin tonë. Duke e parë gjithë këtë përkushtim,

besimin e ndërsjellë, unitetin dhe përkushtimin e angazhimit të vazhdueshëm të koordinatorit Ymer Ymeri dhe stafit qendror për të realizuar me sukses çdo detyrë dhe objektivë në shërbim të anëtarësisë jam i sigurt se do të vazhdojmë ta prezantojmë zërin dhe mendimin tuaj kudo në takime me institucionet qendrore e lokale, por edhe në komunikimin ndërkombëtar sindikal.

Respekt për angazhimin dhe përkushtimin në shërbim të Vjollca Shala, Ymer Ymeri, Blendor Shatrit, Afërdita Ahmetit, Albina Arifit, Lutfi Mani, Vlora Rexhepi Berisha dhe Nezafete Jakupit. Respekt për angazhimet e kryetarëve të nivelit komunal sindikal dhe të Universiteteve, për anëtarët e Këshillit Drejtues, për kryetarët e shoqatave sindikale dhe për gjithë anëtarësinë.

Bashkë e në SBASHK sot e gjithmonë me objektiva të qarta e drejt arritjeve të reja.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sugjerime për përfshirjen edhe të ndonji rubrike në interes të anëtarësisë në gazetën e juaj elektronike Arsimi sot.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë, së shpejti do të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në ueb-faqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK)

përfaqëson rreth 20.500 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit Internacional (EI)** që nga viti 1996.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel. +383(0)38/ 226 940



Intervista

Intervistë me koordinatorin për organizim të brendshëm Ymer Ymeri

Arritje të mëdha në një vit plot sfida



Ymer Ymeri është menaxher për financa e administratë, por vullnetarisht kryen edhe detyrën e koordinatorit për organizim të

brendshëm, e cila ka kërkuar dhe kërkon shumë angazhime e përpjekje shtesë me qëllim që detyrat e përcaktuara të realizohen. Ymeri, i ndihmuar nga stafi qendror është angazhuar maksimalisht duke realizuara kështu detyrat dhe objektivat në shërbim të anëtarësisë dhe prandaj edhe janë shënuar rezultate të shumta. Ai në intervistën për gazetën “Arsimimi sot” do të tregojë për disa nga angazhimet e arritjet e SBASHK-ut në vitin 2020.

Arsimimi sot:

Si e vlerësoni vitin 2020, sa keni arritur të realizoni objektivat në shërbim të anëtarësisë?

Ymeri:

Viti 2020 ishte tepër i vështirë për arsimin në Kosovë dhe për arsimin në tërë botën shkaktuar nga përhapja e pandemisë Covid 19. Mirëpo SBASHK-u edhe në këtë situatë ka vepruar dhe është angazhuar me tërë mundësitë për realizimin e objektiveve dhe kërkesave të anëtarësisë. Unë bashkë me gjithë stafin qendror e në bashkëpunim të ngushtë me kryetarët e nivelit komunal sindikal e të Universiteteve e duke pasur përkrahjen e udhëheqjes së SBASHK-ut u angazhuam dhe kemi arritur me sukses të realizojmë detyrat e planifikuara bashkërisht.

Arsimimi sot:

Si e vlerësoni vazhdimin e traditës për pushimet e një numri të konsideruar të anëtarëve të SBASHK-ut në bregdetin shqiptar?

Ymeri:

Situata e krijuar nga pandemia kishte krijuar edhe dilema lidhur me organizimin e këtij aktiviteti, por uniteti i përfaqësuesve të SBASHK-ut dhe përkushtimi i stafit qendror bëri që pushimi i 420 anëtarëve të

përzgjedhur nga shkollat dhe njësitë akademike të realizohet me plot sukses në dy etapa kohore në bregdetin shqiptar. Angazhimi i komisionit për këtë aktivitet dhe qëndrimi dinjitoz i pushuesve bëri që të lëmë përshtypje të shkëlqyera dhe të kalohen këto pushime pa as edhe një problem të vogël. Jemi krenar dhe ndjehemi mirë duke kujtuar bisedat me pushuesit dhe duke lexuar përshtypjet e tyre, që i ruajmë me kujdes në arkivin e SBASHK-ut. Kjo traditë do të vazhdojë edhe në të ardhmen sepse ky është një respekt meritë për punën e përkushtimin e kolegëve tanë në shërbim të arsimit dhe të arsimimit e edukimit të brezave.

Arsimimi sot:

Një aktivitet tjetër i realizuar me shumë sukses ishin edhe trajnimet e licencuara të SBASHK-ut

Ymeri:

Po e kemi realizuar me kujdes e në përpikëri edhe këtë aktivitet duke respektuar kështu vullnetin e mijëra kolegëve tanë kudo në Kosovë. Rrethanat e reja diktuan që trajnimet t'i organizojmë e realizojmë përmes platformës gjegjëse dhe unë përgëzoj zyrtaren për trajnime dhe tërë stafin qendror bashkë me trajnerët e angazhuar për punën dhe përkushtimin. Po ashtu falënderoj edhe kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe të Universiteteve që janë angazhuar për rrjedhën e mbarë të këtij aktiviteti. U realizuan trajnime me qindra grupe në trajnimet “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqjen efektive të dialogut social”, “Udhëheqja dhe planifikimi strategjik në Arsimin Parauniversitar”, “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”, “Edukimi medial dhe roli i tij në zhvillimin shoqëror dhe demokratik”, “Mësimdhënia e gjuhës dhe letërsisë shqipe për ciklin fillor dhe të mesëm”.

Shifrat dëshmojnë se në këtë aktivitet të organizuar gjatë gjithë këtyre muajve të vitit 2020 kanë marrë pjesë 4000 anëtarë të SBASHK-ut nga e tërë Kosova dhe kështu shihet se është plotësuar objektivi që të trajnohen 20% e numrit të anëtarëve për të vazhduar

me këtë përqindje edhe për çdo vit tjetër derisa të jenë të përfshirë të gjithë anëtarët e SBASHK-ut në këtë aktivitet, që u sjell njohuri të reja, por edhe u mundëson që të realizojnë orët e caktuara të trajnimeve për licencat e punës, por edhe për t'u përgatitur për procesin e gradimit, që pritet të nis në të ardhmen.

Arsimimi sot:

Cilin nga aktivitetet do ta veçonit dhe ndjeheni veçmas krenar që e keni organizuar?

Ymeri:

Të gjitha aktivitetet që i kemi bërë në shërbim të anëtarësisë na bëjnë të ndjehemi krenar, por mbase do të veçoja organizimin nëpër vite të Manifestimit madhështor dedikuar kolegëve tanë të pensionuar pikërisht në ditën e madhe të mësuesit dhe shkollës shqipe. Këtë vit ky aktivitet ishte i veçantë dhe u organizua në Pallatin e sporteve "1 Tetori" pak ditë para se të merrej vendimi i institucioneve për mbyllje për shkak të pandemisë dhe kalimin në mësimin nga larg. Pjesëmarrja aq masive në këtë Manifestim madhështor e kolegëve tanë pensionistë që me vite e

dekada ishin në ballë të misionit të tyre të shenjtë të edukimit e arsimimit të brezave dhe prania e përfaqësuesve më të lartë të institucioneve të shtetit tonë, bashkë me mysafirë të nderuar, mediave të nderuara e të Ansamblit Autokton "Rugova" dhe respekti i lartë e meritë i shprehur nga ta për punëtorët e arsimit na bëri të ndihemi krenar dhe ta harrojmë gjithë lodhjen e krijuar gjatë përgatitjes me përkushtim të këtij aktiviteti.

Arsimimi sot:

Cili është mesazhi juaj për gjithë anëtarësinë e SBASHK-ut?

Ymeri:

I përgëzoj gjithë anëtarët e SBASHK-ut që nga çerdhet, Arsimi Parauniversitar dhe Universitetet për përkushtimin dhe unitetin dhe ju premtojmë se edhe në të ardhmen do të angazhohemi me gjithë mundësitë e pa u kursyer në shërbim të realizimit të kërkesave të tyre.

Gjatë muajit

U mbajtën takimet përmbyllëse të Kryesisë dhe Këshillit Drejtues

Vlerësim i angazhimeve e arritjeve, marrëveshje çka tutje


Në përmbyllje të vitit 2020 SBASHK ka organizuar takime të ndara me Kryesinë dhe me Këshillin Drejtues, si organ më i lartë i SBASHK-ut mes dy Kongreseve.



Në këto takime të ndara të organeleve udhëheqëse të SBASHK-ut kryetari Rrahman jasharaj ka paraqitur një raport të shkurtër duke u ndalur në disa nga aktivitetet e zhvilluara me sukses gjatë vitit 2020 duke

kujtuar takimet e shumta me përfaqësues të institucioneve qendrore në të cilat është debatuar për kërkesat e anëtarësisë së SBASHK-ut, përfaqësimin e SBASHK në takime e aktivitetet ndërkombëtare sindikale, organizimin e Manifestimit madhështor për ditën e madhe të mësuesit dhe shkollës shqipe, vazhdimin e traditës për pushimet e një numri të konsiderueshëm të anëtarësisë në bregdetin shqiptar, organizimin e trajnimeve me grupe të shumta bazuar në vullnetin dhe kërkesat e anëtarësisë, përkushtimin dhe kontributin e lart në rrjedhën e procesit mësimor në këto kushte tejet të vështirësuar nga pandemia dhe aktivitete e angazhime të tjera. Pjesëmarrësit në këto takime kanë përgëzuar stafin qendror dhe veprimtarët sindikal për angazhimet dhe arritjet e shumta. Koordinatorin për organizim të brendshëm Ymer Ymeri është ndalur edhe te organizimi i trajnimeve duke theksuar se janë arritur rezultate të larta dhe është

realizuar objektivi i paraparë nga organet e SBASHK-ut. Ai pastaj këtë e ka dokumentuar me shifra e fakte duke treguar për numrin e pjesëmarrësve në këtë katër trajnimet e organizuara gjatë gjithë vitit 2020.




Në takimin e vetë përmbyllës Kryesia e SBASHK-ut i ka dhënë vlerësim pozitiv Projektbuxhetit të SBASHK-ut për vitin 2021 duke vlerësuar se është përgatitur saktë e me kujdes dhe se mundëson që të realizohen objektivat dhe aktivitetet sindikalë në shërbim të anëtarësisë e që janë paraparë për vitin 2021.



Në takimin nga larg me anëtarët e Këshillit Drejtues ishin të pranishëm edhe kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe të Universiteteve. Edhe në këtë takim nga larg kryetari i SBASHK-ut ka paraqitur një raport të aktiviteteve dhe ka kujtuar shumë nga aktivitetet dhe angazhimet në shërbim të anëtarësisë. Ky raport është plotësuar nga pjesëmarrësit, të cilët duke vlerësuar lart angazhimin e SBASHK-ut kanë kujtuar edhe aktivitete të tjera që janë zhvilluar në nivelin qendror e lokal e të cilat kryetari nuk i kishte

përfshirë në raportin e tij vjetor të aktiviteteve sindikale. Pjesëmarrësit kanë aprovuar këtë raport e pastaj koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri duke u përgjigjur në pyetjet e pjesëmarrësve është ndalur te trajnimet e organizuara gjatë këtij viti dhe pjesëmarrësit kanë përgëzuar atë dhe stafin qendror për organizim të suksesshëm të këtij aktiviteti në shërbim të anëtarësisë e duke kërkuar që të vazhdohet edhe në të ardhmen me trajnimet. Pas kësaj anëtarët e Këshillit Drejtues me kujdes kanë analizuar Projektbuxhetin e prezantuar për vitin 2021 dhe njëzëri e kanë aprovuar atë duke vlerësuar se është i qartë dhe se mundëson realizimin e objektivave dhe detyrave angazhimeve konkrete në vitin 2021 në shërbim të anëtarësisë.



Pjesëmarrësit e këtyre tri takimeve kanë debatuar dhe kanë caktuar detyra konkrete lidhur me zgjedhjet në SBASHK, të cilat në vitin 2021 do të fillojnë në shoqatat sindikale të institucioneve arsimore, për të vazhduar pastaj te Kuvendet Sindikale të Arsimit Parauniversitar e të Universiteteve, pastaj te Kuvendet e tri niveleve arsimore. Nga këto zgjedhje do të dalin me votën e lirë të anëtarësisë organet udhëheqëse sindikale të shkollave e Universiteteve, të niveleve arsimore dhe do të zgjidhen edhe delegatët e Kongresit të radhës dhe anëtarët e Këshillit Drejtues në përmbyllje të këtij aktiviteti SBASHK-u do të përgatitet për Kongresin e radhës, që do të mbahet në fund të muajit shkurt apo në javën e parë të muajit mars 2022.

ETUCE mbajti më 1 e 2 dhjetor Konferencën zgjedhore

Në raportin e punës vend meritë për angazhimet e SBASHK-ut

Kryesia dhe Byroja ekzekutive e Komitetit të Sindikatave të Arsimit të Evropës (ETUCE), që është pjesë e Internacionales së Arsimit, kishin bërë me kohë përgatitjet për mbajtjen e Konferencës zgjedhore duke e caktuar Portugalinë si vend mikpritës, por rrethanat e krijuara nga Covid kanë bërë që kjo ngjarje e madhe për arsimin e Evropës të organizohet nga larg përmes platformës gjegjëse. Në këtë Konferencë zgjedhore të ETUCE merr pjesë edhe SBASHK me 3 delegatë dhe 3 vëzhgues dhe me të drejtën për 21 vota sipas sistemit votues të këtij Komiteti Sindikal të Evropës, pasi është nga sindikatat me numër të madh anëtarësh.



Në hapje të kësaj Konference dyditore, kryetarja e ETUCE, Kristine Blover ka shprehur respekt për të gjitha sindikatat anëtare dhe për përkushtimin e delegatëve e vëzhguesve, që edhe përkundër rrethanave të reja, janë bërë pjesë aktive e kësaj ngjarje të rëndësishme. Blover ka përgëzuar punëtorët e arsimit nga e tërë Evropa për angazhimin dhe përkushtimin në shërbim të arsimit në kushtet dhe rrethanat e krijuara nga Covid 19. Ajo pastaj ka paraqitur në emër të kryesisë dhe organeve udhëheqëse të ETUCE-s raportin e punës dhe aktivitetëve. Duke bërë një analizë të gjendjes në arsim dhe bashkëpunimit me sindikatat anëtare, znj. Blover ka treguar edhe për komunikimin dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm me SBASHK-un duke theksuar se arsimi në Kosovë, si kudo në Evropë, është përballur me sfida të shumta, por gëzon fakti se punëtorët arsimor me të gjitha mundësitë janë angazhuar vazhdimisht për rrjedhë sa më të mbarë të

mësimin nga larg nga marsi e deri në përfundim të vitit të kaluar arsimor. Kryetarja Blover pse kushtet ekonomike të një numri familjesh kanë vështirësuar pjesëmarrjen e rregullt të disa nxënësve në procesin mësimor nga larg. Kryetarja e ETUCE-s duke vlerësuar situatën aktuale në arsim ka kujtuar institucionet dhe Qeveritë për rolin e madh të punëtorëve arsimor duke u shprehur se ne jemi duke organizuar konferencë me ane të teknologjisë, dhe kjo është e vërtetë, por në mësim teknologjia mund të ndihmojë mësimdhënësit por kurrë nuk mund t'i zëvendësojë ata. Pjesëmarrësit e kësaj konference kanë aprovuar raportin e punës dhe kanë shprehur respekt meritë për angazhimet e kryetares Blover, drejtorja e përgjithshme e ETUCE-s, Suzan Flocken dhe gjithë stafit të ETUCE-s.




Konferenca ka vazhduar punimet me fjalën përshëndetëse të drejtores e përgjithshme të ETUCE-s, Suzan Flocken. Ajo ka falënderuar gjithë sindikatat anëtare për përkushtimin, angazhimin dhe bashkëpunimin e pastaj ka dhënë sqarime edhe lidhur me mënyrën e votimit për kryetarin dhe anëtarët e kryesisë. Pas kësaj delegatët e autorizuar kanë votuar dhe nga votat e përfaqësuesve të gjithë sindikatave anëtare kryetar i ri i ETUCE është zgjedhur përfaqësuesi i Sindikatës së Mësimdhënësve të Skocisë, Lary Flanagan. Pas kësaj është votuar edhe për anëtarët e Kryesisë. SBASHK i është gëzuar zgjedhjes së gjithë krerëve të ETUCE-s e në veçanti zgjedhjes së nënkryetarëve Branimir Shtrikel nga sindikata e arsimit të Sllovenisë (SVIZ) dhe znj. Trudi Kerperien nga sindikata e arsimit të Holandës (AoB) që janë miq të vjetër të SBASHK-ut dhe kanë

mbështetur vazhdimisht me vite e dekada sindikatën e arsimit të Kosovës kudo në takimet ndërkombëtare sindikale.

Duke zhvilluar punimet në ditën e dytë, më 2 dhjetor, është vazhduar me bashkëbisedat dhe debatet me qëllim që të krijohet një platformë dhe një plan i aktiviteteve konkrete për 5 vitet e ardhshme në shërbim të punëtorëve arsimor të Evropës duke i dhënë hapësirë bashkëpunimit mes sindikatave , komunikimit të vazhdueshëm dhe mbështetjes të

cilës do anëtare në situata të sfidave të ndryshme, ashtu si është vepruar edhe deri tani.



SBASHK nënshkroi një marrëveshje të veçantë me OHTK-në

Përpyjekje e angazhime të përbashkëta në shërbim të anëtarësisë

SBASHK-u në përpyjekjet për të përkrahur arsimin në tërësi dhe në mbështetje të anëtarësisë ka nënshkruar një varg marrëveshjesh me bizneset, institucionet shëndetësore , Komplekset Turistike, por edhe me sindikata të tjera.



Në mbyllje të këtij viti SBASHK ka nënshkruar edhe një marrëveshje të veçantë dhe kjo ndodhi për arsye se sindikata jonë me punë e përkushtim ka arritur të gëzojë respekt kudo në Kosovë. Është fjala për nënshkrimin e marrëveshjes me Odën e Hotelierisë e Turizmit të Kosovës. Kjo marrëveshje është nënshkruar në praninë e medieve dhe në këtë ceremoni kanë marrë pjesë edhe kryetari e nënkryetari i BSPK-së Avni Ajdini e Atdhe Hykolli dhe koordinatori për organizim të brendshëm në SBASHK , Ymer Ymeri.



Kryetari i OHTK-së, prof. dr. Hysen Sogojeva, që po shoqërohej në këtë ceremoni nga nënkryetari i Odës dhe anëtarë të kryesisë, është shprehur se ky është një moment i veçantë për të dy palët dhe është zotuar se Oda do të jep kontribut të vazhdueshëm në respektimin dhe vënien në jetë të pikave që janë përcaktuar në këtë marrëveshje bashkëpunimi.

Kryetari i BSPK-së , Avni Ajdini ka përgëzuar përgatitur Odën e Hotelierisë dhe Turizmit për arritjet dhe për ecjen e sigurt përpara duke u forcuar vazhdimisht në anëtarë të rinj nga ky sektor.



Kryetari i SBASHK-ut Rahman Jasharaj ka kujtuar se Kosova ka resurse të turizmit dhe se Oda do të ndihmojë në zhvillimin edhe më të madh të këtij sektori. Ai ka apeluar të kreu u OHTK-së që me anëtarët e vetë të ndihmojnë shkollat profesionale dhe nxënësit atje me qëllim që ata të jenë sa më të përgatitur e të suksesshëm në profesionin e tyre. Në hotelieri e turizëm. Jasharaj është shprehur i sigurt se derisa nuk krijohen kushtet që edhe OHTK-ja të jetë edhe anëtar të Këshillit Ekonomik – Social , BSPK dhe SBASHK – u me anëtarët e vet do të jenë një zë i kësaj Ode.

Takim me kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe Universiteteve Arritje të shumta edhe përkundër kushteve të vështirësuar

Me qëllim të këmbimit të informacioneve për situatën aktuale në arsim dhe për kërkesat legjitime të anëtarësisë stafi qendror i SBASHK-ut gjatë gjithë vitit 2020 ka mbajtur komunikim të rregullt e të vazhdueshëm me kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe të Universiteteve. Po ashtu janë mbajtur shumë takime me këta kolegë e kolege. Në takimin përmbyllës të vitit 2020 me kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe të Universiteteve është analizuar dhe janë vlerësuar angazhimet dhe arritjet e SBASHK-ut.




Kryetari i SBASHK-ut Rahman Jasharaj në fillim të takimit përmbyllës ka paraqitur një raport duke treguar angazhimet, sfidat, aktivitetet dhe arritjet e sindikatës sonë duke ritheksuar se ky ishte njëri nga vitet më të vështira për arsimin e Kosovës. Ai ka shprehur respekt meritore dhe ka përgëzuar stafin qendror dhe kryetarët e nivelit komunal sindikal e të Universiteteve për angazhimet dhe arritjet e shënuara dhe për bashkëpunimin dhe koordinimin e vazhdueshëm të aktiviteteve në shërbim të anëtarësisë.




zyrtare të MASH lidhur me numrin mjaft të madh të punëtorëve arsimor dhe nxënësve që janë prekur nga

Covid, por edhe për kundër kësaj ata me mund e sakrifica kanë bërë që procesi mësimor mos të ndalet as edhe për një moment. Jasharaj pastaj ka shpalosur pjesë nga aktivitetet duke filluar nga janari 2020 e për të ardhur kështu deri në këtë fundvit.



Pas kësaj duke biseduar për angazhimet dhe arritjet në këtë vit koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri ka shpalosur disa nga aktivitetet e realizuara gjatë gjithë vitit 2020 duke veçuar Manifestimin madhështor kushtuar ditës së madhe të mësuesit dhe shkollës shqipe, organizimit të shkëlqyer të pushimeve në bregdetin shqiptar për më shumë se 400 kolegë nga e tërë Kosova, respektimin në tërësi të vullnetit të mijëra kolegëve tanë për organizimin trajnimeve, takimet e shumta me institucionet qendrore e lokale duke prezantuar në mënyrë të denjë kërkesat dhe shqetësimet e arsyeshme të anëtarësisë, përfaqësimi i denjë i SBASHK-ut në takimet sindikale ndërkombëtare dhe një varg angazhimesh të tjera. Në pjesën e dytë të këtij takimi është zhvilluar një bashkëbisedë për angazhimet sindikale dhe për aktivitetet në komunat e Kosovës dhe në Universitete.



Kryetari i Kuvendit të Sindikatës së Universiteteve në kuadër të SBASHK-ut, Bardh Bardhi e ka vlerësuar të vështirë, por edhe të suksesshëm këtë vit. Ai pastaj ka kujtuar disa nga aktivitetet e zhvilluara

sindikale nëpër të 7 Universitetet e Kosovës. Kanë treguar për aktivitetet dhe arritjet e sfidat edhe të gjithë kryetarët e nivelit komunal sindikal duke veçuar aktivitetet kyçe. Ata kanë shprehur respektin e lartë të tyre dhe anëtarësisë për përkushtimin dhe angazhimet e stafit qendror në shërbim të anëtarësisë dhe i kanë përgëzuar ata për arritjet e shumta edhe pse u punuar

SBASHK-u rëndësi të veçantë informimit me kohë e të saktë Çdo informacion arriti me kohë te anëtarësia

SBASHK-u edhe gjatë vitit 2020 i ka kushtuar rëndësi të veçantë informimit të saktë e me kohë të anëtarësisë lidhur me të gjitha angazhimet, sfidat dhe aktivitetet e zhvilluara nga SBASHK e në shërbim të anëtarësisë. Kjo është arritur me organizimin e shumë takimeve nga larg me kryetarët e nivelit komunal sindikal e të Universiteteve, me Këshillin Drejtues ,me kryetarët e shoqatave sindikale të institucioneve arsimore, por edhe me publikimin e informatave të botuara në ueb faqen dhe facebook-un e SBASHK-ut dhe falë bashkëpunimit korrekt me të gjitha mediet e shkruara e elektronike.



Për t'i pasur bashkë e në të njëjtin vend shumicën e aktiviteteve, angazhimeve, sfidave e arritjeve të SBASHK-ut vazhdon tradita e botimit të gazetës “Arsimimi sot” për çdo muaj e po ashtu vazhdon të botohet edhe gazeta vjetore “Rrugëtimi i SBASHK-ut”, e cila do të botohet dhe do të shpërndahet nëpër institucionet e arsimit të Kosovës.

në kushte tepër të vështirësuar.

Pjesëmarrësit e këtij takimi pastaj janë pajtuar me rendin e punës që është paraparë për takimin e Kryesisë dhe Këshillit Drejtues dhe kanë shprehur dëshirën që edhe ata ta përcjellin rrjedhën e takimit të Këshillit Drejtues.



SBASHK-u shpreh respekt për mediet e shkruara e elektronike, të cilat kanë përcjellë në vazhdimësi edhe gjatë këtij viti aktivitetet dhe angazhimet e SBASHK-ut, kanë botuar me korrektësi shumë reagime e informata nga SBASHK-u. Premtojmë se edhe në ardhmen do të

angazhohemi brenda mundësive dhe në bashkëpunimin e sinqertë e korrekt me mediet që çdo informacion që ndërlidhet me aktivitetet e angazhimet e SBASHK-ut të arrijnë me kohë te anëtarësia dhe opinionin në Kosovë.




Vazhdojnë trajnimet edhe gjatë gjithë muajit dhjetor


Pjesëmarrësit e vlerësojnë lart këtë aktivitet të SBASHK-ut

Teksa po bëhej raporti përfundimtar dhe po bëhej një vlerësim i tërësishëm i realizimit të trajnimeve gjatë vitit 2020, koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri bashkë me stafin vazhdojnë me mobilizimin dhe po organizojnë trajnime edhe gjatë gjithë muajit dhjetor, e madje edhe në këto ditët e fundit të vitit duke respektuar kështu në përpikëri kërkesat dhe vullnetin e anëtarësisë nga e tërë Kosova.






Në vazhden e këtij aktiviteti gjatë gjithë vitit ishin edhe trajnimet e nisura më 12 dhjetor me grupet e ndara sipas vullnetit të anëtarësisë në trajnimet “Mësimdhënia e gjuhës dhe letërsisë shqipe për ciklin fillor e të mesëm”, “Udhëheqja dhe planifikimi strategjik në arsimin Parauniversitar” dhe “Edukimi medial dhe roli i tij në zhvillimin shoqëror e demokratik”. Këto grupe kanë vazhduar me trajnimet edhe për tri ditë të tjera nën udhëheqjen e trajnerëve Trajnerët Blerina Haraçija, Fisnik Zuka, Nazif Jashari, Ibadete Bajrami, Zenun Nimami e Besa Ramabaja kanë bërë gjithë angazhimet për të arritur objektivat e caktuara dhe për të përballuar sfidat eventuale ata janë ndihmuar e mbështetur nga trajnerët me përvojë prof. dr. Hysen Sogojeva, prof. dr. Atdhe Hykolli dhe trajnerë të tjerë të angazhuar nga stafi qendror i SBASHK-ut.




Me të përfunduar trajnimet me këto grupe koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri bashkë me stafin qendror e në bashkëpunim me kryetarët e nivelit komunal sindikal e të Universiteteve kanë nisur trajnimet me grupe të tjera bazuar në vullnetin e shumë kolegëve tanë nga komunat e Kosovës. Trajnimet e nisura të shtunën e 26 dhjetorit “Edukimi medial dhe roli i tij në zhvillimin shoqëror dhe demokratik” me trajnerët Sami Shala e Cyme

Sejfiqaj, trajnimi “Udhëheqja dhe planifikimi strategjik në Arsimin Parauniversitar” me trajneren Arberina Hajzeri, trajnimi “Mësimdhënia e gjuhës dhe letërsisë shqipe për ciklin fillor e të mesëm” me trajnerin Kadri Tahirukaj dhe në trajnimin “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqjen efektive të dialogut social” me trajneren Nora Haliti kanë vazhduar edhe për tri ditë me radhë për të realizuar në tërësi programin e paraparë të trajnimeve.




Edhe në fillimet e trajnimeve të organizuara gjatë gjithë muajit dhjetor janë kyçur dhe kanë bashkëbiseduar me pjesëmarrësit kryetari Rahman Jasharaj, koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri, kryetari i Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar për Malishevën Skënder Gashi, zyrtari ligjor Blendor Shatri dhe prof. dr. Atdhe Hykolli e disa trajnerë të tjerë me përvojë.




Kryetari i SBASHK-ut Rahman Jasharaj ka falënderuar trajnerët për angazhimin e pastaj ka përgëzuar pjesëmarrësit dhe kolegët tanë kudo në Kosovë për angazhimin dhe përkushtimin në misionin e shenjtë të edukimit e arsimit të brezave në këto kushte e rrethana tepër të vështirësuar nga pandemia Covid-19. Ai ka shprehur respekt për koordinatorin për organizim të brendshëm Ymer Ymeri dhe stafin qendror të cilët, si tha ai, krahas shumë detyrave e angazhimeve tjera, kanë arritur që me sukses të

realizojnë edhe këtë aktivitet, i cili po realizohet me sukses duke shënuar arritje të larta.



Koordinatori për organizim të brendshëm në SBASHK, Ymer Ymeri ka dhënë sqarime të duhura lidhur me rrjedhën e trajnimeve duke këshilluar

pjesëmarrësit që të jenë të rregullt në aktivitetet dhe se kjo do të vërtetohet nga evidencat e trajnerëve, por edhe nga kyçjet e koordinatorit, i cili ka sqaruar se kur bëhet evidentimi për pjesëmarrje duhet të jenë të kyçura kamerat dhe se vijimi, si në trajnimet e kaluara, duhet të jetë i rregullt.



Gjest domethënës në Fakultetin e Bujqësisë e Veterinarisë

Respekt meritor për tre pishtarët e pensionuar të dijes

Në sallën e konferencave të Fakultetit të Bujqësisë e Veterinarisë menaxhmenti në bashkëpunim me shoqatën sindikale të këtij institucioni arsimor kanë organizuar një ceremoni me qëllim që të shprehin respektin meritor me rastin e pensionimit të tre profesorëve të nderuar: Prof. Dr. Sylë Sylanaj, Prof. Dr. Shukri Fetahu dhe Prof. Dr. Ragip Kastrati. Ishte ky një gjest domethënës dhe shprehje e respektit meritor për këta tre pishtar të dijes dhe për kontributin e lartë që ata kanë dhënë nëpër vite e dekada në shërbim të arsimit të gjeneratave.



Dekani i Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë Prof. Asoc. Dr. Bedri Dragusha, në shenjë respekti për punën e palodhshme shumëvjeçare u ndau këtyre tre pishtarëve të dijes

Mirënjohje me titullin “Për kontributin e dhënë arsimit të gjeneratave të reja dhe shkencave Bujqësore e Veterinare në Kosovë”.

Pjesëmarrësit në këtë ceremoni festive u kanë shprehur mirënjohje e respekt: Prof. Dr. Sylë Sylanaj, Prof. Dr. Shukri Fetahu dhe Prof. Dr. Ragip Kastrati për përkushtimin dhe angazhimet e tyre duke i uruar për pensionimin dhe duke iu dëshiruar shëndet të mirë dhe mbarësi në jetë.



Kryetari i shoqatës sindikale në këtë Fakultet, z. Muharrem Berisha është shprehur se ndjehet krenar që bashkë me menaxhmentin kanë organizuar këtë ceremoni festive për të dëshmuar respektin e lartë e meritor ndaj këtyre tre pishtarëve të dijes duke shtuar se ata, edhe pse janë pensionuar, gjithmonë do të konsiderohen se janë pjesë e këtij institucioni të arsimit dhe do të kërkohen vazhdimisht këshillat e tyre në shërbim të ngritjes së vazhdueshme të cilësisë në arsim.

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

Pas një varg takimesh të Komisionit për Kontratë Kolektive të Arsimit

Pajtueshmëri për përmbajtjen e Kontratës Kolektive, pritet nënshkrimi i saj

Njëra nga çështjet e diskutuara në takimet me Ministrin Likaj ishte edhe çështja e Kontratës Kolektive të Arsimit. Ishte marrëveshje e përbashkët që të krijohet komisioni në përbërje të të cilit do të jenë përfaqësues nga MASH dhe SBASHK për të negociuar lidhur me tekstin final të Kontratës Kolektive.



Në këtë Komision, SBASHK-un e kanë përfaqësuar Ymer Ymeri, koordinator për organizim të brendshëm, Bardh Bardhi, kryetar i Kuvendit të Sindikatave të Universiteteve dhe Blendor Shatri, zyrtar ligjor në SBASHK, ndërsa MASH e kanë përfaqësuar Isni Kryeziu, drejtor i zyrës ligjore në MASH –kryesues i Komisionit, Gëzim Berisha, shef i kabinetit të Ministrisë, Enver Osdautaj, këshilltar i lartë i Ministrisë,

i cili më vonë është zëvendësuar nga Luan Kryeziu, këshilltar dhe Fehmi Zylfiu, udhëheqës i financave në MASH.



Në këto takime është vërejtur atmosferë pune e përkushtimi dhe kjo ka bërë që të arrihet edhe pajtueshmëri për tekstin final të Kontratës së Arsimit të Kosovës, tekst ky që pastaj bazuar në procedurat është dërguar në zyrën ligjore të MASH e pastaj edhe në lekturim për të plotësuar kështu gjithë kriteret dhe tani SBASHK arsyeshëm pret që Ministri i MASH, Ramë Likaj dhe kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj sa më shpejtë ta nënshkruajnë Kontratën Kolektive të Arsimit të Kosovës.

